



# BAZAT E SHËRBESËS PASTORALE

VËLLIMI 1

Të jesh pastor

UDHËZUES STUDIMI

---

“Historia e kishës e bën të qartë  
që kisha e Jezu Krishtit nuk përparon  
dhe nuk do të përparojë përtej përparimit  
frymëror të udhëheqësve të saj.”

**ALISTAIR BEGG**

---

*The Basics of Pastoral Ministry: On Being a Pastor (Study Guide)*

Copyright © 2021 by Truth For Life

P. O. Box 398000 Cleveland, OH 44139

Bazat e shërbesës pastorale - Vëllimi 1: Të jesh pastor (Udhëzues studimi)

Botuar me leje.

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla ABS 2009.

Përdorur me leje nga Albanian Bible Society (A.B.S.).

# HYRJE

Predikimet e këtij vëllimi kanë për qëllim t'i ndihmojnë ata që janë pastorë, ata që dëshirojnë të bëhen pastorë, si dhe udhëheqësit e pashuguruar, që të kenë një kuptim edhe më të qartë të thirrjes dhe punës së tyre. Fillimisht, këto predikime dhe leksione nuk janë përcjellë të bashkuara në një seri të lidhur. Për pasojë, në këto predikime ka mbivendosje përmbajtjeje. Mesazhet e këtij vëllimi u zgjodhën dhe u renditën për të qenë sa më të dobishme për ata që po trajnohen për shërbesë. Ne shpresojmë dhe lutemi që të përfitoni së tepërmi prej tyre, ndërsa përpiqeni ta përlëvdoni Perëndinë kudo që ai ju ka vendosur.

Çdo mësim përfshin katër pjesë kryesore:

**1) Shkrime kyç:** vargje të rëndësishme nga Bibla, të cilave u referohet mesazhi dhe që janë shënuar për meditim dhe mësim përmendsh.

**2) Shënime:** hapësira (si edhe përvijime kur është me vend) ku të mund të shkruani mësimet kyç, mendimet dhe pyetjet nga çdo mesazh.

**3) Vështrim në thellësi:** citate dhe pyetje për t'ju ndihmuar që të konsideroni idetë kryesore të çdo mesazhi.

**4) Mënyra se si të luteni:** shtysa të cilat kanë për qëllim që t'ju ndihmojnë t'ia paraqisni kërkesat dhe ndjenjat tuaja të thella Perëndisë.

## Objektivat e nxënies

- Të shqyrtoni natyrën e thirrjes pastorale, si dhe përkushtimet parësore të një shërbese të dhënë nga Perëndia.
- Të konsideroni rëndësinë e udhëheqjes besnike dhe mënyrën se si të këmbëngulni gjatë majave dhe luginave të udhëheqjes.
- Të mësoni se si të zhvillonin dhe të zbatoni një vizion për një kishë lokale, dhe si ta udhëhiqni atë përmes ndryshimit.

## Le të fillojmë

1. Shqyrtoni rolin dhe qëllimin e pastorit në jetën e një kishe lokale. Cilat mendoni se janë bindjet dhe detyrat parësore, të cilave duhet t'u përkushtohet një pastor në shërbesën e tij?

---

---

---

---

2. Shërbesa mund të jetë plot me pengesa, vështirësi, kundërshtime dhe me zhgënjime të tjera të larmishme. Cilat janë disa prej sfidave më të mëdha me të cilat do të përballen pastorët?

---

---

---

---

# MËSIMI NJË

## Shenjat e një shërbese të dhënë nga Perëndia

Letra e Palit drejtuar Kolosianëve na siguron një standard përmes të cilit kisha e sotme mund të përcaktojë shenjat e një shërbese të dhënë nga Perëndia. Duke e parë Palin si model, Alistair Begg-u na prezanton me modelin, qëllimin dhe kënaqësinë e punës së pastorit. Me anë të energjisë dhe aftësimin të Perëndisë, pastorët mund ta paraqesin të vërtetën e Fjalës së Perëndisë në tërë plotësinë e saj, duke nxitur kështu unitet dhe pjekuri frymërore në bashkësitë e tyre.

## Shënime

### Hyrje

---

---

---

---

### Model i shërbesës së pastorit

---

---

---

---

---

---

### Qëllimi i shërbesës së pastorit

---

---

---

---

---

### Kënaqësia e shërbesës së pastorit

---

---

---

---

---

---

## SHKRIME KYÇ

“Shërbenjës i së cilës u bëra unë, sipas administrimit të Perëndisë që m’u dha për ju, që t’jua paraqes të plotë fjalën e Perëndisë.” (Kolosianëve 1:25)

“Që ne e kumtuam [Krishtin], duke e paralajmëruar dhe duke e mësuar çdo njeri me çdo urtësi, që ta paraqesim çdo njeri të përsosur në Krishtin Jezus; për këtë edhe mundohem duke u përpjekur, sipas veprueshmërisë së tij që vepron tek unë me fuqi.” (Kolosianëve 1:28-29)

“Sepse dua që të dini ç’luftë të madhe kam për ju dhe ata që janë në Laodice dhe të gjithë ata të cilët nuk e kanë parë fytyrën time në mish, që zemrat e tyre të ngushëllohen, duke u lidhur në dashuri, dhe të kenë të gjitha pasuritë e sigurisë së plotë të mençurisë, për të njohur misterin e Perëndisë, pra, edhe të Atit edhe të Krishtit.” (Kolosianëve 2:1-2)

## Vështrim në thellësi

1. *“Nuk e zgjedh pastori detyrën apo misionin e tij. Shërbesa pastorale jepet nga Perëndia prej qiellit.”*

Edhe pse të gjithë të krishterët janë thirrur të shërbejnë në mënyra të ndryshme, shërbesa pastorale është një thirrje e veçantë nga Perëndia. Nëse tashmë je pastor apo ke interes që të jesh, si mund ta dallosh që je thirrur nga Perëndia? Cilat janë rreziqet e mundshme nëse bëhesh pastor pa pasur një thirrje të qartë?

---

---

---

---

---

2. *“Çdo shërbesë e cila e anashkalon ose e nënçmon vendin dhe përparësinë e mesazhit të plotësisë së shpalljes së Perëndisë, është një shërbesë që, në fund, nuk do të sjellë dobi.”*

Përmes udhëzimit të Fjalës së Perëndisë, burrat dhe gratë vijnë në besim dhe në pjekuri. Pavarësisht kësaj, udhëheqësit e shërbesës shpesh tundohen ta ndërtojnë shërbesën e tyre përmes diçkaje tjetër dhe jo përmes shpalljes së Fjalës së Perëndisë. Si mund t’i bëni ballë këtij tundimi dhe të këmbëngulni në ruajtjen e përparësisë së predikimit të Fjalës së Perëndisë?

---

---

---

---

---

3. “Është përleshje të jesh njeri që lutet. Është përleshje të jesh pozitiv. Është përleshje të vazhdosh përpara nën dritën e pengesave, nën dritën e shkurajimeve... Është përleshje të qëndrosh në shërbesë pastorale në një kishë, javë pas jave, në vazhdimësi.”

Siç e përmend edhe Alistair-i, shërbesa mund të jetë shkurajuese dhe plot me përleshje. Si mund të qëndroni të inkurajuar, në mënyrë që të vazhdoni në shtegun e shërbesës?

---

---

---

---

---

## Mënyra për t’u lutur

- Nëse je i sigurt që je thirrur në shërbesën pastorale, lutu që Perëndia të të japë vendosmëri për ta përmbushur thirrjen tënde. Nëse mendon se mund të jesh thirrur në shërbesë pastorale, por ende nuk je i sigurt, lutu që Perëndia të të japë qartësi për thirrjen tënde.
- Vlerëso vendin dhe përparësinë e shpalljes së Fjalës së Perëndisë në shërbesën tënde, dhe lutu që të jesh i palëkundshëm në përkushtimin tënd për ta predikuar Fjalën e Perëndisë.
- Lutu për veten dhe për udhëheqës të tjerë të shërbesës të cilët i njeh, që mund të jenë të shkurajuar. Lut u që Perëndia të sigurojë inkurajim dhe forcë të re për të këmbëngulur në luftën e mirë të besimit.